

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik – Vushtrri

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë : " **ROA Consulting "sh.p.k. me seli në Podujevë**, Autoriteti Kontraktues - Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjekt në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën **02.08.2023**, merr këtë:

V E N D I M

- 1. Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin pasuksesshëm, të subjektit në procedure: " **ROA Consultin "sh.p.k. – Podujevë**, në procedurën prokurimit me titull: " **Furnizimi me TV dhe projektot e mbajtës të projektorit për shkolla, sipas Lot. 1 dhe Lot. 1 " Lot. 1 – Furnizimi dhe instalimi i TV në shkolla " me Nr.i prokurimit: VU644-23-4956- 1-2-1 & Nr. i brendshëm: VU644-23-060-121**
- 2. Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues - Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. **25.07.2023**

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues - Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që për Lot. 1 " **Furnizimi dhe instalimi i TV në shkolla " ta rekomandoi për dhënie të kontratës: OE.: " Mediatech & Printy "sh.p.k. " me seli në Prishtinë, ndërsa O.E.: " **ROA Consulting "sh.p.k. (në tekstin e mëtejme Ankuesin) për shkak të çmimit më të lartë dhe bazuar në Kriterin e dhënie së kontratës " Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë " ta radhis në mesin e O.E. të pasuksesshëm, bazuar në procedurën e zbatuar.****

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e pasuksesshëm për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike me dt. **25.07.2023**, bazuar në dispozitat e nenit 43 të Rregullores mbi Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se, duke vendosur si në Vendimin e dt. **25.07.2023**, A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së, konkretisht: nenin 1 – Qëllimi, nenin 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve lidhur me nenin 69 – Aftësia Teknike dhe / ose Profesionale dhe nenin 60 – Kriteret për dhënie të kontratës.

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtuara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë, për arsye se:

- 1. Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.** Sipas nenit 1 të LPP-së , A.K. ka pasur për qëllim që, bazuar në kushtet dhe rregullat e specifikuara, procedurën e zbatuar, të siguroj mënyrën më efikase më transparente dhe më të drejtë të realizoi shfrytëzimin e fondeve publike dhe burimeve publike të A.K., neni 7 ka pasur për qëllim trajtimin e barabartë, pa diskriminuar asnjë prej O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dh krahasimi i tenderëve) lidhur me nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 (**tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët**) ka pasur për qëllim, që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimit dhe vlerësimi të tenderëve, të vendosë për dhënie të kontratës O.E. **me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.** Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se **Vendimi i A.K. i dt. 25.07.2023** është marrë bazuar në kushtet, rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent, duke përfshirë këtu edhe të drejtën Ankuesit për të realizuar qasjen në dokumente të tenderit, konform nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës: OE.: " Mediatech & Printy " sh.p.k. është marrë në mes tjerash edhe në zbatimin e nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përmbushë kërkesat administrative, profesionale dhe minimalisht ato teknike dhe / ose profesionale të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.
3. Sa i përket pretendimeve të Ankuesit, lidhur me Specifikimet Teknike, AK vlerëson se fakti që, sikurse O.E. tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, edhe O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar Deklaratën me shkrim , të nënshkruar dhe vulosur se, citat : " *malli i ofruar i përmbushë në tërësi specifikat teknike të specifikuara nga A.K.* " është tregues i vlefshëm dhe i qartë se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës, si O.E. i propozuar, respektivisht pajisjet teknike të O.E. , i plotësojnë kërkesat e definuara në Specifikat Teknike të Dosjes së Tenderit me theks të veçantë sa i përket cilësisë, performancës, dhe sigurisë, ndërsa që, bazuar në Specifikat Teknike, A.K. do të arrij ti përmbushë qëllimet e tija sa i takon realizimit të buxhetit dhe sigurimit të mallit të kërkuar, me theks të veçantë TV-së, andaj pretendimi i Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës është i papërgjegjshëm për arsye se modeli i ofruar i TV-së nuk përmban procesorin sipas kërkesave të saktësuar në Specifikat Teknike të Dosjes së Tenderit dhe se A.K. ka rekomanduar për dhënie të kontratës O.E. të papërgjegjshëm është plotësisht jo i argumentuar dhe për rrjedhojë i paqëndrueshëm.
4. Lidhur me pretendimin e Ankuesit se A.K., me rastin e zbatimit të procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, ka shkëlur nenin 69 të LPP-së, sepse O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës është i papërgjegjshëm, A.K. vlerëson se dëshmitë e O.E. për të treguar se i përmbushë kërkesat lidhur me aftësitë e tija teknike dhe / ose profesionale janë në pajtim me Kërkesat e specifikuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, neni II.2.4 – Kapaciteti teknik dhe Profesional. Kjo dëshkohet përmes dokumentit-dëshmisë : Katalog me përshkrim të Specifikave Teknike minimale. Duhet pasur parasysh se , *bazuar në nenin 41.11 të RUOPP, citat : " Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga proceduara e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit "* dhe po ashtu A.K. ka pasur parasysh që Specifikimet Teknike të jenë të sakta dhe precize dhe të mos kuptohet se ato paraqesin kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Prandaj, sikurse ka vlerësuar dhe konstatuar A.K. dëshmitë e dorëzuara nga O.E. për të dëshmuar se i përmbushë kërkesat lidhur me aftësitë teknike dhe / ose profesionale nuk paraqesin ndonjë devijim material, apo kufizime sa i përket kriterëve të përzgjedhjes. Mbi këto konstatime, vlerësimi i A.K. është se Tenderi i O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të Dosjes së Tenderit, është në pajtueshmëri me përshkrimin dhe kërkesat sa i përket Specifikimeve Teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit si dhe është dorëzuar nga O.E. që përmbushë kriteret e përzgjedhjes të specifikuara në Dosjen e Tenderit. Më tej A.K. ka vlerësuar se dëshmitë e dorëzuara nga O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës janë të mjaftueshme dhe se nuk ka pasur nevojë që, në kuptim dhe / ose zbatim të dispozitave të nenit 72 të LPP-së lidhur me nenin 41.7 të RUOPP, të kërkoj nga Tenderuesi të sqaroi tenderin e tij.
- Si përfundim lidhur me pretendimet e Ankuesit lidhur me këtë pikë, **A.K. vlerëson se Tenderi i O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës është i përgjegjshëm sepse tenderi është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.**
5. Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit janë të pabazuara, të pasakta dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Përfundimisht, A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit si ai i dt. 25.07.2023 për të përzgjedhur për rekomandim me dhënie të kontratës të O.E.: " Mediatech & Printy "sh.p.k., nuk ka elemente apo prova se janë shkëlur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, me theks të veçantë neni 1 - Qëllimi, nenin 6- Ekonomiciteti dhe efikasiteti, neni 7 - Barazia në trajtim/ Jo diskriminimi sepse është rekomanduar O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët, ndërsa me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo barabartë apo diskriminuar, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 51 - Njoftimi i kriterëve të dhënies së kontratës dhe neni 59 paragraf 4 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Nga sa u tha me lartë, e në pajtim me nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 të Rregullave për paraqitje të kërkesë për rishqyrtim, A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


Udhëzim Juridik : Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në OSHP, në pajtim me dispozitat e nenit 109 të LPP-së lidhur me nenin 9 të Rregullave për parashtrimin e ankesës pran OSHP-së.

Autoriteti Kontraktues - Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 060/2023 - datë : 02. 08.2023

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik



Alban Tahiraj